



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.116/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Kymete Kicaj dhe Ferki Xhaferi anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Vlerona Maliqi, duke vendosur përkritazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së posterit në hapësira publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 06 tetor 2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 30.09.2019, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet e bazuar ankesa e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, Anr.116/2019 e datës 27.09.2019, ndërsa subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 2,100.00 (dy mijë e njëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Me datë 27.09.2019, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, me të cilën pretendon se më datë 27.09.2019, në Rr.”Remzi Ademaj”, në Prizren, nga ana e monitoruesve të tyre është parë një poster i njërit nga kandidatët për deputet nga radhët e partisë politike Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), ngjitur në hapësira publike, respektivisht në shtylla të ndriçimit publik, përgjatë gjithë rrugës, veprim ky i cili sipas tyre bie në kundërshtim me nenin 33 par.1, pika b) të LZP-së.

Ankuesi si dëshmi për pretendimet e tij, ankesës i ka bashkangjitur disa fotografi të posterëve të kandidates për deputet nga radhët e subjektit politik LDK, Hyrë Tejeci, të ngjitur në shtyllë elektrike.

Në përgjigjen në ankesë të datës 28.09.2019, subjekti politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), ka konsideruar se ankesa e KDI-së është e pabazuar, me arsyetimin se në kushtet në të cilat është duke u zhvilluar fushata zgjedhore, marrë parasysh faktin se komunat nuk kanë arritur që të krijojnë hapësira të veçanta për vendosjen e materialeve zgjedhore ashtu siç përcaktohet me dispozita ligjore, vendosja e posterit në një shtyllë elektrike nuk do të duhej të trajtohej si shkelje. Më tej subjekti politik në fjalë, në përgjigjen e tij në ankesë ka shtuar se shtyllat elektrike, pavarësisht faktit se janë “pronë publike”, në Kosovë, zakonisht ato janë përdorur edhe për vendosjen e njoftimeve të ndryshme mbi ngjarje dhe zhvillime në komuna përkatëse, si pasojë e mungesës së hapësirave të dedikuara për këtë qëllim. Sipas tyre, me vendosjen e një njoftimi apo posterit të një kandidati nuk dëmtohet dhe as nuk cenohet

funksionaliteti i shtyllës. Në fund ka njoftuar se nga ana e këtij subjekti politik, janë ndërmarrë veprimet e duhura për evitimin e shkeljes, duke larguar fotot e vendosura, me ç'rast ka bashkangjitur edhe një foto ku shihet largimi i posterit të kandidats për deputete nga radhët e këtij subjekti politik.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se posteri i kandidates për deputete nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, është ngjitur në hapësirë publike, respektivisht në shtyllë elektrike, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33, pika b), të LZP-së e cila dispozitë përcakton: “ *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike* ”.

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), është shkelur dispozita e lartëcekur ligjore, pasi që posteri i kandidates për deputete nga radhët e subjektit politik LDK, është vendosur në objektin publik përkatësisht në shtyllë elektrike e cila konsiderohet pronë publike dhe nuk është hapësirë e dedikuar për vendosje të posterëve.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë; si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

PZAP-i, me rastin e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi, mori parasysh pretendimet subjektit politik LDK, të cilat pretendime i vlerësoi si të pa ndikim për të vendosur ndryshe. Paneli vlerësoi se subjekti politik LDK, brenda afatit të caktuar nga PZAP-i, ka ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes, i cili veprim ka ndikuar në shqiptimin e gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, sepse sipas nenit Rregullores së PZAP-it Nr. 01/2012, shkeljet e kësaj natyre të Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, mund ti shqiptohet gjobë subjektit politik nga 5,100.00 euro deri në 10,000.00 euro, mirëpo siç u konstatua me lart, veprimet e subjektit politik LDK, për ta përmirësuar shkeljen, ka ndikuar në shqiptimin e gjobës.

Paneli, me këtë vendim ka për qëllim që të ndikon te subjekti politik LDK, që mos të përsërit veprimet e kësaj natyre në të ardhmen, andaj nga arsyet e theksuara me lartë e në kuptim të nenit 120 paragrafi 1 pika c) dhe nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr. 116/2019 më datën 30.09.2019

Kryesuesi i Panelit

Zyhdi Haxiri



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 1 të LZP-së.